

## RELACION

### PËR

#### PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.10093, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE”

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Ky projektligj ka për qëllim miratimin e disa ndryshimeve dhe shtesave dhe ndryshime në Ligjin nr.10093, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” që do të sjellin si rezultat rritjen e efikasitetit institucional dhe ndërveprimin me shoqërinë civile si aktorë kryesorë në zhvillimin e një shoqërie demokratike.

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektligji nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten në Këshillin e Ministrave, për vitin 2026.

#### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Problematikat gjatë zbatimit të ligjit nr. Nr.10093, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” kanë diktuar si nevojë ndryshimet e propozuara, të cilat do të ndikojnë në mbarvajtjen e veprimtarisë së AMSHC-së dhe rritjen e efikasitetit institucional në mbështetje të shoqërisë civile. Gjithashtu ky ndryshim vjen në vijim të gjetjeve nga Raporti i SiGMA i kryer në vitin 2025, lidhur me “Forcimin e qendrës së qeverisjes në Shqipëri”. Objekti kryesor i këtij raporti kishte të bënte me vlerësimin e situatës aktuale si dhe dhënien e rekomandimeve me fokus forcimin e qendrës së qeverisjes së Shqipërisë, duke integruar në mënyrë efektive parimet e Qeverisjes së Përbashkët në përputhje me parimet e Administratës Publike, veçanërisht ato që lidhen me koherencën e politikave, planifikimin strategjik, hartimin e politikave të bazuara në prova dhe konsultimin me palët e interesuara, duke mbështetur kështu vendin në rrugëtimin drejt anëtarësimit në BE, e njëkohësisht duke siguruar qeverisje më efektive, ofrim më të mirë të shërbimeve dhe zbatim të qëndrueshëm të politikave. Raporti, ndër të tjera ka evidentuar shpërndarjen e përgjegjësive që kanë qendrat e qeverisjes në vendet e OECD-së, të cilat konsistojnë kryesisht në funksionet strategjike për të gjithë qeverinë, përgatitja e programit të qeverisë dhe monitorimi i zbatimit të politikave. Në këtë kontekst, është vlerësuar se këto praktika ndërkombëtare ofrojnë njohuri të vlefshme edhe

për Shqipërinë, e cila po kalon reforma gjithëpërfshirëse të qeverisjes si pjesë e procesit të pranimit në BE, duke kontribuar në identifikimin e ekuilibrit optimal midis koordinimit të centralizuar dhe mbikëqyrjes strategjike nga njëra anë, dhe delegimit efektiv dhe bashkëpunimit ndërministror nga ana tjetër, duke rritur ndjeshëm koherencën e politikave, efikasitetin administrativ dhe efektivitetin e qeverisjes. Nga sa më lart, raporti ka kryer edhe një vlerësim të situatës aktuale në Shqipëri, duke theksuar se struktura administrative mbetet shumë e centralizuar, me 26 autoritete dhe agjenci që raportojnë drejtpërdrejt te Zyra e Kryeministrit.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Ky projektligj mbështetet në nenet 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Ky projektligj nuk synon të përafrojë *acquis* të Bashkimit Evropian.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji është i përbërë nga 8 nene me përmbajtjen si më poshtë:

##### **Neni 1**

Pika 4 e nenit 2, ndryshohet si më poshtë vijon:

“4.Statuti i AMSHC miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe propozimet për të përcaktohen me vendim të bordit mbikëqyrës, i cili vendimin e përcjell nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë përgjegjëse për mirëqënien sociale.

***Argument:*** *Kjo dispozitë është përshtatur duke marrë parasysh përcaktimin ligjor që i bëhet rrugëtimit ligjor që do të kenë vendimet e bordit për t’u cuar në Këshillin e Ministrave ndërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë përgjegjëse për mirëqënien sociale, përgjegjëse për Shoqërinë Civile, duke pasur parasysh edhe gjetjet nga Raporti i SiGMA i kryer në vitin 2025, lidhur me “Forcimin e qendrës së qeverisjes në Shqipëri”.*

##### **Neni 2**

Në nenin 8, fjalia e dytë e pikës 4, ndryshohet si më poshtë vijon :

...“Organizatave e shoqërisë civile, të regjistruara sipas ligjit, kanë të drejtë t’i dërgojnë propozimet për përfaqësim në bordin mbikëqyrës, pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë përkatëse për mirëqënien sociale, e cila ka në fushë veprimtarie shoqërinë civile.”

***Argument:*** *Kjo dispozitë përshtatet në përputhje me ndryshimet e nevojshme dhe futet roli i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë përgjegjëse për mirëqënien sociale, e cila ka në fushë veprimtarie shoqërinë civile, për të bërë të mundur realizimin e procedurës për afishimin e thirrjes për kandidatët që aplikojnë për të qënë pjesë e Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.*

### **Neni 3**

Në nenin 9, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “f” shfuqizohet.
2. Në shkronjën “g” pas togëfjalëshit “për veprimtarinë e AMSHC-së” shtohet “nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë përgjegjëse për mirëqënien sociale.”

**Argument :**

1. *Shfuqëzohet për shkak se Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së prej vitit 2015 (Shkresës e DAP nr. 648/1 prot, datë 20.02.2015 , me lëndë ‘Emërim si Nënpunës Civil i nivelit të lartë drejtues , anëtar i TND-së’ ) gëzon status TNT në përputhje me ligjin Nr.152/2013, i ndryshuar.*
2. *Përshtatur sipas ndryshimeve që orientohen për të përcaktuar rolin që Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë përkatëse për mirëqënien sociale, e cila ka në fushë veprimtarie shoqërinë civile do të ketë.*

### **Neni 4**

Pika 4 e nenit 12 shfuqizohet.

**Argument :**

*Shfuqëzohet për shkak se Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së prej vitit 2015 (Shkresës e DAP nr. 648/1 prot, datë 20.02.2015 , me lëndë ‘Emërim si Nënpunës Civil i nivelit të lartë drejtues , anëtar i TND-së’ ) gëzon status TNT në përputhje me ligjin Nr.152/2013, i ndryshuar.*

## **Neni 5**

Në nenin 13, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 shfuqizohet.
2. Në pikën 4, hiqen fjalët “ose i drejtorit ekzekutiv”.

### **Argument :**

*Shfuqëzohet për shkak se Drejtori Ekzekutiv i AMSHC-së prej vitit 2015 (Shkresës e DAP nr. 648/1 prot, datë 20.02.2015 , me lëndë ‘Emërim si Nënpunës Civil i nivelit të lartë drejtues , anëtar i TND-së’ ) gëzon status TND në përputhje me ligjin Nr.152/2013, i ndryshuar.*

## **Neni 6**

Pika 3 e nenit 15 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Nivelet e pagave dhe të shpërblimit të punonjësve të AMSHC-së, si dhe të kryetarit e anëtarëve të bordit mbikëqyrës miratohen nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të AMSHC-së rregullohen sipas legjislacionit në fuqi për shërbimin civil. Marrëdhëniet e punës për punonjësit administrativë rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

*Argument: Kjo dispozitë ndryshohet për shkak të përshtatjes që duhet të ketë, sepse prej vitit 2015 marrëdhëniet e punës për stafin e AMSHC-së menaxhohen sipas legjislacionit në fuqi për shërbimin civil. Përrjashtëmish rregullohen me Kod Pune marrëdhëniet e punës për punonjësit administrativë (sekretar i drejtorit ekzekutiv, magazinier dhe njësitë e përkohëshme si njësia për KKSHC-në).*

## **Neni 7**

Në nenin 26, pas paragrafit të parë, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Vendimet e bordit mbikëqyrës për miratimin e dhënies së grantit ankimohen në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë sipas afateve të parashkuara në legjislacionin e posaçëm në fuqi.”.

*Argument : Është shtuar pika 2 në nenin 26 me qëllim identifikimin e natyrës së vendimeve të Bordit Mbikëqyrës, të cilat për shkak të natyrës të tyre dhe efektit që kanë për të tretë të ankimohen në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si gjykata kompetente përsa i takon përcaktimeve që Kodi i Procedurave Administrative të RSH përcakton në lidhje me aktet me natyrë administrative dhe një palë shtet.*

#### **Neni 8**

Parashikon hyrjen në fuqi të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10093, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për mbështetjen e shoqërisë civile”.

### **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHET PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT**

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale.

### **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektligji është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale si dhe nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

### **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektligji nuk shoqërohet me efekte financiare, që do të përballohen brenda buxhetit të shtetit, për vitin 2026 e në vijim.

**PROPOZUES**

**MINISTRI**

**EVIS SALA**